

KËRKESË
Nr. 4776/2, datë 3.8.2020

PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i mikrohapësirave publike, Sheshi Selita”, Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, i ndryshuar, personat e tretë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e plotësimit të afateve të publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16,376,556 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Artan Shkreli**

**LLOGARITJET PARAPRAKE E PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I
MIKROHAPËSIRAVE, SHESHI SELITA” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5**

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall m ²	Sip. truall i prekur m ²	Çmimi truall lek/m ²	Vlera truall e prekur (lekë)	Vlera truall (lekë)	Konfirmim i Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Jug	Shënime në kartelë
1	Shtet	Truall	8260	3/719	87.1	82.0	30,783	0	0	Konfirmohet me shkresën nr. prot.579/1, datë 12.6.2019 dhe rikonfirmohet me shkresën nr. prot. 4985/1, datë 22.5.2020	
2	Bashkëpronarët Ylli, Bogdani, Biba	Truall	8260	3/142	320.0	320.0	30,783	9,850,560	9,850,560	Konfirmohet me shkresën nr. prot.579/1, datë 12.6.2019 dhe rikonfirmohet me shkresën nr. prot. 4985/1, datë 22.5.2020	Në seksioni E të kartelës ka shënimin: Ka ndërtime pa leje
3	Bashkëpronarët Ylli, Bogdani, Biba	Truall	8260	3/202	252.80	212.0	30,783	6,525,996	6,525,996	Konfirmohet me shkresën nr. prot.579/1, datë 12.6.2019 dhe rikonfirmohet me shkresën nr. prot. 4985/1, dt. 22.5.2020	Në seksioni E të kartelës ka shënimin: Ka ndërtime pa leje
4	Shtet	Truall	8260	3/22	632.5	76.0	30,783	0	0	Konfirmohet me shkresën nr. prot.579/3, datë 11.7.2019 dhe rikonfirmohet me shkresën nr. prot. 4985/1, datë 22.5.2020	Në seksionin D të kartelës ka shënimin: Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa nr.

											3/829-Nd, vol. 56, f. 76, ZK 8260
5	Shtet	Truall	8260	3/26	30.22	30.22	30,783	0	0	Konfirmohet me shkresën nr. prot.579/3, datë 11.7.2019 dhe rikonfirmohet me shkresën nr. prot. 4985/1, datë 22.5.2020	Në seksioni E të kartelës ka shënimin: Okupues banorë pallati nr. pas 3/25
SHUMA						720.22			16,376,556		

Shënime.

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.
2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste janë bazuar në të dhënat e marra nga konfirmimi i Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Jug, me shkresat nr.prot.579/1, datë 12.6.2019, nr. prot. 579/3, datë 11.7.2019 dhe nr. prot. 4985/1, datë 22.5.2020.